



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 tetor 2020  
Nr.ref.:RK 1631/20

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI106/19**

Parashtrues

**Mark Nikolla**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë  
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 496/18, të 20 marsit 2019**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mark Nikolla, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Ac. nr. 496/18] të 20 marsit 2019 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Urdhrin [P. nr. 364/14] të 12 janarit 2018 të Përmbaruesit privat.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 59 [Llojet e vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 24 qershor 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu - Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
7. Më 11 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
8. Më 18 korrik 2019, Gjykata i dërgoi shkresë parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga ai të plotësohet kërkesa.
9. Më 24 dhe 26 korrik, si dhe 8 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
10. Më 16 gusht 2019, Gjykata njoftoi përmbaruesin privat, Gjokë Radi.
11. Më 7 tetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 27 prill 2011, parashtruesi i kërkesës së bashku me Z. N. si debitor dhe ProCredit Bank (në tekstin e mëtejme: PCB) si kreditor lidhën marrëveshje mbi kredinë me nr. 4038649.

13. Më 15 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës së bashku me Z. N. si debitor dhe PCB si kreditor lidhën kontratën e kredisë për biznes me nr. 40043736.
14. Kreditori PCB, pas disa vërejtjeve të dërguara debitorëve për mospagesën e kredisë, parashtroi propozim për përmbarim pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përkatësisht për shitjen e paluajtshmërive të hipotekuara për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve ndaj saj.
15. Më 28 prill 2014, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [E. nr. 454/2014], lejoi përmbarimin sipas propozimit të kreditorit për sekuestrim të kolateralit dhe ekzekutim në paluajtshmëri - hipotekë.
16. Më 18 shtator 2014, Gjykata Themelore përmes konkluzionit [E. nr. 454/14], ia transferoi komplet lëndën Përmbaruesit privat Gj. R. në Gjakovë [në tekstin e mëtejme: Përmbaruesi privat], për vazhdimin e procedurës së përmbarimit.
17. Më 22 shtator 2014, Përmbaruesi privat njoftoi palët në procedurë për vazhdimin e përmbarimit pranë zyrës së tij përmbarimore.
18. Debitori i dytë, Z. N., ushtroi prapësim kundër Aktvendimit [E. nr. 454/2014], të Gjykatës Themelore.
19. Më 23 prill 2015, Gjykata Themelore me Aktvendimin [PPP. nr. 19/14], refuzoi prapësimin si të pabazuar dhe theksoi se ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore.
20. Kundër Aktvendimit [PPP. nr. 19/14] të Gjykatës Themelore, debitori i dytë, Z. N., parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
21. Më 9 mars 2017, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ac. nr. 2530/15], refuzoi si të pabazuar ankesën e debitorit të dytë Z. N., dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP. nr. 19/14].

#### **Përmbledhja e fakteve në procedurën përmbarimore pranë Përmbaruesit privat**

22. Pas kthimit të lëndës nga Gjykata e Apelit tek Përmbaruesi privat, ky i fundit nxjerr konkluzion për shitjen e paluajtshmërive, përmes ankandit publik më 26 prill 2017, dhe caktoi datën e shitjes publike më 26 maj 2017.
23. Parashtruesi i kërkesës përmes parashtrësës së 3 majit 2017, nga Përmbaruesi privat kishte kërkuar shtyrjen e përmbarimit deri në muajin shtator, për shkak se e kishte motrën e sëmure dhe nuk do të mund të merrte pjesë në seancë.
24. Në seancën e mbajtur më 26 maj 2017, i autorizuari i kreditorit ishte pajtuar për shtyrjen e seancës brenda një afati të arsyeshëm, mirëpo jo deri në shtator. Andaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për shtyrje të seancës ishte aprovuar dhe ankandi publik për shitjen e paluajtshmërive ishte caktuar më 23 qershor 2017. Edhe ky ankand kishte dështuar për shkak të mungesës së të interesuarve për blerje.

25. Më 24 korrik 2017, ishte caktuar mbajtja e ankandit të dytë. Gjatë kësaj seance, me pajtimin e kreditorit dhe debitorit, përmbarimi lidhur me këtë lëndë ishte shtyrë deri më 10 nëntor 2017, në pritje që palët të arrijnë marrëveshje për kthimin e kredisë së mbetur.
26. Meqenëse nuk ishte arritur ndonjë marrëveshje për pagimin e kredisë, i autorizuari i kreditorit kishte kërkuar vazhdimin e përmbarimit. Me kërkesën e kreditorit, më 14 nëntor 2017, Përmbaruesi privat kishte nxjerrë konkluzion dhe kishte caktuar anakndin e dytë publik për datën 15 dhjetor 2017.
27. Më 15 dhjetor 2017, ishte mbajtur ankandi i dytë publik ku ofertues i vetëm për blerjen e paluajtshmërive ishte i autorizuari i kreditorit. Shuma e ofruar për blerjen e paluajtshmërive u konstatua në 1/3 e vlerës së përcaktuar. Përmbaruesi privat përmes konkluzionit të nxjerrë në të njëjtën ditë pranoi që paluajtshmëritë t'i shiten ofertuesit, në këtë rast kreditorit.
28. Më 12 janar 2018, Përmbaruesi privat nxori Urdhrin [P. nr. 367/14] ku theksoi se (i) shiten paluajtshmëritë e debitorit Z. N. nga Gjakova; (ii) Paluajtshmëritë i shiten kreditorit ProCredit Bank – dega në Gjakovë, sipas kushteve mbi bazën e konkluzionit për shitjen publike të 15 dhjetorit 2017; (iii) detyrohen debitorët dhe gjithë mbajtësit e tjerë, që kreditorit t'ia lirojnë paluajtshmëritë lëndore nga njerëzit dhe sendet e tyre që ndodhen në to dhe t'ia dorëzojnë ato paluajtshmeri në posedim kreditorit; (iv) shërbimi pronëso-ro-juridik pranë Drejtorisë Komunale për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjakovës do të bëjë fshirjen e të drejtave të pronësisë nga debitori Z. N. nga Gjakova dhe paluajtshmëritë nga pika I e këtij Urdhri t'i regjistroj si pronë në emër të kreditorit – blerësit ProCredit Bank – dega në Gjakovë.
29. Më 18 janar 2018, parashtuesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Urdhrit [P. nr. 367/14] të 12 janarit 2018 të Përmbaruesit privat, për shkak të parregullsive me rastin e kryerjes së përmbarimit.
30. Më 20 mars 2019, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ac. nr. 496/18], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtuesit të kërkesës, në lidhje me Urdhrin përmbarimor të 12 janarit 2018, me arsyetimin: *“Gjykata e Apelit vlerëson se organi përmbarues, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marrë urdhër të drejtë dhe bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e organit përmbarues, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se urdhri i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkellje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe është zbatuar e drejta materiale, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e këtij urdhri, shkellje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së”*.
31. Më 15 maj 2019, parashtuesi i kërkesës parashtroi propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 496/18] të 20 marsit 2019.

32. Më 5 qershor 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij nuk është aprovuar, për arsye se në këtë çështje nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimeve të kontestuara atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
34. Parashtruesi i kërkesës konsideron se kreditori i kishte shkaktuar dëme sepse siç thekson ai, kreditori i “ *ka bllokuar frigoriferët të lënë si kolateral me ç’ rast për shkak të këtij veprimi më është prishur i tërë malli dhe ka ardhë deri tek prishja e frigoriferëve, andaj në rastin konkret kreditori më ka shkaktuar dëm material, duke llogaritur edhe kështet e paguara më të larta se shuma e kredisë, andaj me ka sjellë dëm të barabartë*”.
35. Parashtruesi i kërkesës me tej pretendon se në rrethanat e rastit të tij (i) me rastin e zbatimit të procedurave të përmbarimit pranë Gjykatës dhe Përmbaruesit privat është bërë shkelje e dispozitave të procedurës së përmbarimit; dhe (ii) shkelje e dispozitave të Ligjit mbi procedurën kontestimore, meqenëse sipas tij të njëjtat dispozita përshtatshmërisht zbatohen edhe në procedurën e përmbarimit. Parashtruesi i kërkesës në këtë aspekt thekson se ai si palë nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë, duke rezultuar kështu në shkelje të së drejtës së tij të garantuar me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
36. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që të anulohen vendimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe konkluzionet e Përmbaruesit privat Gj. R.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

37. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

[...].

39. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.*

40. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shterur mjetet efektive juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe ka dorëzuar kërkesën në kohë.
41. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

42. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që debitorët, përkatësisht parashtruesi i kërkesës dhe kreditori, përkatësisht PCB, kishin lidhur marrëveshje për kredi. Si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga debitori, kreditori kishte kërkuar fillimin e procedurës së përmbarimit për vlerën e mbetur të kredisë. Gjykata Themelore në Gjakovë kishte lejuar përmbarimin dhe lënda ishte transferuar te Përmbaruesi privat. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, debitori Z. N. kishte parashtruar prapësim në Gjykatën Themelore ku nga kjo e fundit ishte refuzuar, ankesën e tij e kishte refuzuar edhe Gjykata e Apelit. Pas vendosjes për ankesën nga Gjykata e Apelit, Përmbaruesi privat përmes konkluzioneve përkatëse kishte caktuar ankandet publike për shitjen e



paluajtshmërisë së përcaktuar me marrëveshje në vlerën prej 35000 €. Sipas shkresave të lëndës, paluajtshmëria i ishte shitur PCB-së, në ankandin publik të 15 dhjetorit 2017, në një të tretën (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, përkatësisht 11, 666.67 €. Si rezultat, Përmbartuesi privat kishte nxjerrë Urdhrin për shitjen e paluajtshmërisë. Debitorët, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, kishte kontestuar këtë Urdhër në Gjykatën e Apelit, e cila përmes Aktvendimit [Ac. nr. 496/18] të 20 marsit 2019 e kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorëve. Më pas parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë pranë zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku ky i fundit nuk e aprovoi propozimin e parashtruesit. Në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës e konteston aktvendimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar, në esencë, se “*procedura përmbartimore ishte kundërkushtetuese dhe kundërligjore*”.

43. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendimet e tij i ndërlidhë (i) me trajtim jo të barabartë me palët e tjera në procedurë dhe (ii) pretendon se autoritetet kompetente, në këtë rast Gjykatat dhe Përmbartuesi privat, nuk e respektuan procedurën e përmbartimit dhe me këtë bënë shkelje të dispozitave të Ligjit mbi procedurën kontestimore, meqenëse sipas tij të njëjtat dispozita përshtatshmërisht zbatohen edhe në procedurën e përmbartimit.
44. Lidhur me këto pretendime, dhe siç është reflektuar tek pjesa që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përtej pretendimit se vendimet e gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me nenin 3 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument dhe/ose arsyetim konkret përkitazi me shkeljet e të drejtave të tij e të cilat ai i pretendon.
45. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).
46. Një qëndrim i tillë i Gjykatës është i bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Bazuar në këtë praktikë, dhe atë tashmë të konsoliduar të Gjykatës, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së, të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).

47. Gjykata gjithashtu rikujton se Gjykata e Apelit kishte adresuar pretendimet e parashtruesit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 496/18] të 20 marsit 2019, ku ndër të tjera kishe theksuar:

*“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, Urdhri për shitjen është i drejtë konform dispozitës së nenit 222 të LPP-së, ngase pasi të kryhet procedura për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, organi përmbarues jep konkluzion për shitjen e paluajtshmërisë me të cilin e cakton vlerën e paluajtshmërisë, mënyrën dhe kushtet e shitjes, si dhe kohën dhe vendin e shitjes, po që se shitja bëhet me ankand publik. Organi përmbarues konform nenit 223 të LPP-së, konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë e shpall në tabelën e organit përmbarues me vendimin e organit përmbarues dhe në mënyrë tjetër përkatëse. Mënyra e shitjes së paluajtshmërisë është rregulluar me nenin 227 të LPP-së, ku përcaktohet se shitja e paluajtshmërisë bëhet me anë të ankandit publik verbal, seanca për shitjen e paluajtshmërisë mbahet në ndërtesën e organit përmbarues, në qoftë se organi përmbarues nuk ka caktuar vend tjetër të shitjes. Seanca për shitje mbahet para organit përmbarues”.*

48. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kishin trajtuar dhe arsyetuar në tërësinë e tyre pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe se procedurat para gjykatave në rrethanat e rastit konkret, në asnjë mënyrë nuk rezultojnë të kenë qenë të padrejta apo arbitrare.
49. Siç u sqarua më lart, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk sjell asnjë argument apo arsyetim shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese. Për pasojë, Gjykata bazuar në Rregulloren e saj të punës, përkatësisht paragrafin 2, të rregullit 39 të saj, duhet të shpallë këtë kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
50. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, Aktvendim i 18 tetorit 2017, paragrafi 42).
51. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
52. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, dhe në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës dhe të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 tetor 2020, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

